

1.Informacion mbi shoqërinë

Shoqëria DEVIS Shpk është themeluar si një shoqëri me NIPT: K31420012M. Shoqëria ushtron aktivitetin privat që prej vitit 2003.

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është sherbim lavanderie dhe pastrim kimik, tregimi import-eksport i mallrave me shumice e pakice te ndryshem industrial, hidrosanitare, pastrime kimike, detergjente te ndryshme, konfeksione rrobaqepsi, punime e sherbime te ndryshme ne pastrime kimike, ushqimore, fruta perime, mobilje, kozmetike, lende te perpunuara e te paperpunuara te lendeve medicinale, prodhime e tregtimin e materialeve te ndertimit, bar-bufe, restorante, pjese kembimi, hotele si dhe agjensi te shitblerje.

Selia qëndrore e Shoqërisë është në Tiranë.

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria administrohet nga Znj.Kristinka Leka

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria kishte 91 punonjës.

2.Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare përgatiten duke u bazuar në koston historike, me përjashtin të disa kategorive të aktiveve dhe detyrimeve, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Keto standarte janë te detyrueshme në bazë të Urdhrit të Ministrisë së Financave nr.65, datë 25 maj 2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare te Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të përkthyera në gjuhen shqipe.”

Shoqëria i mban të dhënrat e kontabilitetit dhe i publikon pasqyrat financiare në pajtueshmeri me ligjin mbi kontabilitetin nr. 25/2018, 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

3.Gjykime të rëndësishme kontabël, vlerësimë dhe supozime

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësimë dhe supozime, të cilit ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të reportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Shoqeria kryen supozime dhe bën vlerësimë, të cilat kanë ndikuar në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vendimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazuar në eksperiencën e kaluar dhe faktorë të tjerë, duke perfshirë edhe parashikimet e ngjarjeve të ardhshme të cilat vlerësohen që janë të arsyeshme sipas rrëthanave.

Gjyk imet, vlerësimet dhe supozimet rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen ne periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në ato pasardhëse të ndikuara nga ky ndyshim. Në veçantë, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit, të pasigurisë dhe gjykimeve te rëndësishme në aplikimin e politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar më poshtë.

Parimi i vijimësisë dhe krahasueshmëria

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijueshmërisë.

Informacioni krahasues është paraqitur në përputhje me politikat kontabel që zbatohen nga shoqëria. Janë bërë korigjimet e nevojshme për shifrat krahasuese ne perputhje me ndryshimet në paraqitjet në periudhën aktuale.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Nuk ka politika kontabël dhe dhënie informacionesh shpjeguese të rëndësishme të adoptuara nga shoqëria, të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe pasivet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime matjeje dhe/ose prezantimi bazuar në metodat në vijim. Supozimet në përcaktimin e vlerës së drejtë, kur janë të aplikueshine, prezantohen në shënimin përkatës.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat. Në përcaktimin e provizioneve të tatimit mbi të ardhurat janë të nevojshme çmuarjet. Ekzistojnë shumë transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë gjatë veprimtarisë normale të biznesit. Shoqëria njeh detyrimet për vlerësimet e organeve tatimore bazuar në vlerësimet nëse tatime të tjera shtesë do të lindin si detyrime. Nëse më pas ka diferençë midis detyrimit faktik dhe atij të regjistruar atëherë këto diferenca do të ndikojnë në tatimin mbi të ardhurat dhe provisionet për tatime në periudhën në të cilën është kryer ky krahasim.

4.Përbledhje e politikave bazë kontabël

Polikat kontabel si më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në gjithë periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Transaksionet në monedha të huaja

Regjistrimet kontabël të shoqërisë përgatiten në Lek, që është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon shoqëria.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lek. Duke aplikuar mbi monedhën e huaj kursin e momentit të këmbimit të kësaj monedhe me lek-un në datën e veprimit (kursi spot). Aktivet monetare dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit të pasqyrave financiare konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare të mëparëshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në daten e veprimit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuara me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
EURO (EUR)	121.77	123.42
USD (USD)	108.64	107.82

(a) Aktivet afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë nëse ka. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja përfshin shpenzime që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vet shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e montimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur.) Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionit të pajisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë

e saj.

Në rastet kur pjesët e një aktivi atatgjatë material kanë jetegjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësiinit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen cdo datë raportimi.

Normat e amortizimit, për periudhën aktuale dhe periudhën krasuese janë si më poshtë:

	2019	2018
Ndërtesa	5%	5%
Pajisje dhe makineri	20%	20%
Pajisje zyre	20%	20%
Pajisje informatike	25%	25%
Mjete transporti	20%	20%
Te tjera	20%	20%

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'registrohet kur nxirret jashtë përdorimit apo shitet ose kur nuk priten përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi ose shitja. Cdo fitim ose humbje që rrjedh nga mosnjohja (ç'registrimi) i aktivit (llogaritur si diferenca mes të ardhurave nga pakësimi dhe vlerës kontabël të aktivit), paraqitet në të ardhura ose shpenzime kur aktivi ç'registrohet.

Vlera e mbetur e aktivit, jeta e dobishme dhe metodat e arnortizimit rishikohen cdo periudhe financiare, duke bere ndryshimet e nevojshme sipas rastit në fund të cdo viti finanziar.

(a) Aktivet atatgjata jomateriale

Njohja dhe matja

Aktivet jomateriale te blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien ne vlerë të akumuluar.

Kostot e mëpasshme

Kostot ne vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivi specifik me të cilat lidhen. Te gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit te emrit të mirë dhe markës, njihen në fitim ose humbje në momentin e ndodhjes.

Amortizimi illogaritet mbi koston e aktiveve, ose cdo vlore të konsideruar si kosto minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet ne te ardhura ose shpenzime duke përdorur metoden e vlerës se mbetur me një norme vjetore amortizimi 20% per cdo aktiv.

(b) Zhvlerësim i aktiveve jo financiare

Në çdo datë raportimi shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përvèç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit në mënyrë që të përcaktohet zhvlerësimi. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes.

Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontohen fluksset e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimin para tatimit, e cila reflekton vlerësi aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivit, për të cilat nuk janë bërë rregullime në vlerësimet e bëra për fluksset e mjeteve monetare.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

(c) Inventarët

Inventarët mbahen në vlerën më të ulët të kostos dhe të vleres neto të realizueshme. Kostoja përfshin koston direkte dhe ato indirekte që janë shkak për sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe kushtet e tyre aktuale. Kostoja e inventarëve përfshin: koston e blerjes së mallit, koston e transportit, detyrimet doganore, akcizën etj.

Vlera neto e realizueshme(VNR) paraqet çmimin e vlerësuar të shitjes për inventarët minus shpenzimet e nevojshme për të bërë shitjen.

Manazhimi i shoqërisë gjatë vitit monitoron ne mënyrë periodike çmimet e shitjes me koston e inventarëve dhe ne qoftë se çmimi eshte ulur, diferenca njihet në pasqyrën e te ardhurave gjithpërfshirese si zhvlerësim i inventarëve.

Kostoja e inventarëve është e bazuar në metodën mesatare të kostos. Zhvlerësimi i përshtatshëm për ulje

të vlerës njihet në fitim dhe humbje ku evidencë objektive që VN R është më e ulët se kostoja.

(d) Instrumentët financiare

Një instrument finanziar është çdo kontratë që krijon një aktiv finanziar të një njësie ekonomike dhe një pasiv finanziar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jodervative të shoqërisë përbëhen nga të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, paratë dhe ekuivalentët e tyre, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera, të arkëtueshme dhe të pagueshme nga njësitë ekonomike të grupit.

Aktivet Financiare

i) Njohjo dhe matja fillestare

Aktivet financiare klasifikohen në njohjen fillestare me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) dhe vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivit finanziar dhe nga modeli i biznesit të shoqërisë për menaxhimin e tyre. Përveç llogarive të arkëtueshme tregtare që nuk përbajnë një pörbërës të rëndësishëm financimi ose për të cilat shoqëria ka zbatuar lehtësimet praktike te standartit, shoqëria mat një aktiv finanziar me vlerën e drejtë të tij plus kostot e transaksionit, kjo në rastin e një aktivi finanziar të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

i) Njohja dhe matja fillestare (vazhdim)

Në mënyrë që një aktiv finanziar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ai duhet të krijojë flukse të mjeteve monetare që janë 'vetëm pagesa e principalit dhe interesit (SPPI)' për shumën kryesore të papaguar. Ky vlerësim quhet test SPPI dhe kryhet në nivel instrumenti finanziar.

Modeli i biznesit i shoqërisë per manaxhimin e aktiveve financiare i referohet inënyrës se si menaxhon aktivet e saj financiare në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare, shoqëria ka aktive financiare të arkëtueshme tregtare nga të cilat pret vetëm arketimin e principalit dhe interesit në rast se aplikohet.

ii) Matja e mëpasshme

Për qëllime të matjes se mëpasshme, aktivet financiare klasifikohen në katër kategorit:

- Aktivet financiare me koston e amortizuar (instrumentet e borxhit);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes OCI me riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentet e borxhit);
- Aktivet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes OCI pa riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative në momentin e çregjistrimit (instrumentat e kapitalit neto);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë një zë shumë i rëndësishëm pér shoqërinë. Një e arkëtueshme përfsaqëson të drejtën e shoqërisë pér një shumë të konsiderueshme që është e pakushtëzuar (dmtsh, kërkohet vetëm kalimi i kohës para pagesës së shumës).

Detyrimet financiare

i) Njohja fillestare dhe matja

Detyrimet financiare klasifikohen në njohjen fillestare si detyrime financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit apo humbjes, kreditë dhe huamarrjet, të pagueshme ose derivativë të përcaktuar si instrumente mbrojtës në një mbrojtje efektive sipas rastit.

Të gjitha detyrimet financiare njohen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në rastin e huave dhe të pagueshmeve neto nga kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që iu atribuohen.

Detyrimet financiare të shoqërisë përfshijnë detyrimet tregtare, huamarrje dhe të tjera të pagueshme.

ii) Matjet e mëvonshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- Detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes;
- Me kosto të amortizuar.

iii) Cregjistrimi

Shoqëria çregjistron një detyrim finansiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anullohen ose skadojnë.

Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim finansiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht.Në këtë rast njihet një detyrim finansiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara.

Në çregjistrimi e një detyrimi finansiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

e) Provzionet

Një provzion njihet kur si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëriaka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive, të cilat mund të vlerësohet me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë pér të shlyer këtë detyrim.

h) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqërisë njihet në vlerën nominale. Aksionet e aksionerëve klasifikohen si kapital aksionar.

f) Njohja e të ardhurave

E ardhura nga shitja e mallrave dhe të ardhurat e tjera njihen në pasqyrën e të ardhurave ose shpenzimeve në raport me fazën e plotësimit të transaksionit në datën e raportimit.

j) Shpenzimet operacionale

Shpenzimet operacionale njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ato kryhen.

g) Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të përcaktuara

Shoqëria paguan gjatë aktivitetit të saj kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Kostot e këtyre kontributeve njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën kur ndodhin. Autoritet lokale janë përgjegjës për përcaktimin e pragut minimal për pensionet sipas një plani kontributi të përcaktuar.

Leja vjetore e paguar

Shoqëria njeh si detyrime vlerën e paskontuar të kostove të përllogaritur lidhur me lejen vjetore të parashikuar për tu paguar si shkëmbim i shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

Përfitimet afatshkurtra

Përfitimet afatshkurtra të punonjësve maten me bazë të paskontueshme dhe shpenzohen kur ofrohet shërbimi. Për vlerën e pritshme për tu paguar si përfitim monetar afatshkurtër ose sipas një plani fitim-shpërndarës krijohet një provizion nëse shoqëria ka një detyrim aktual ligor dhe konstruktiv për të paguar këtë shumë si pasojë e një shërbimi të mëparshëm të dhënë nga punonjësi edhe ky detyrim mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

h) Pagesat e qirasë

Qiratë klasifikohen si qira financiare kur termat e qirasë transferojnë në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet te qiramarrësi. Të gjitha qiratë e tjera klasifikohen si qira operacionale. Në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe pasqyrën e të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, qiramarrësi do të paraqesë shpenzimin e interesit mbi detyrimin e qirasë veçmas nga shpenzimi i amortizimit të aktivit me të drejtë përdorimi.

i) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë fitimet nga kursi i këmbimit.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare nëpërmjet fitimit dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare, nëse ka.

j) Tatimi mbi fitimin

Tatimi fitimi përbëhet nga tatimi aktual dhe i shtyrë. Shpenzimi tatim fitimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përvëçse në rastet kur lidhet me elementë që njihen direkte në kapital, në të cilat njihet direkte në kapital. Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshmë mbi fitimin e tatushëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për tu paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e pasqyrave të pozicionit finanziar, duke rezultuar në diferenca të përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të aktiveve dhe pasiveve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit që

pritën të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur anullohen, bazuar në legjislacionin që ka qenë në fuqi osë ka hyrë në fuqi në fund të periudhës së raportimit. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që është e mundur që përfitimet e ardhshme të taksueshme do të jenë të vlefshme ndaj diferencave të përkohshme që mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në cdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më e mundurqë përfitimet e lidhura me atë tatim do të realizohen.

5. Standarde dhe interpretimet e reja

SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët

SNRF 15 zëvendëson SNK 11 ‘Kontratat e ndërtimit’, SNK 18 ‘Të ardhurat’ dhe të gjitha interpretimet e lidhura me to, dhe është i aplikueshëm me përjashtime të vogla, mbi të gjitha të ardhurat që rrjedhin prej kontratave me klientët. SNRF 15 përcakton një model me pesë hapa për njohjen e të ardhurave që rrjedhin prej kontratave me klientët dhe kërkon që të ardhurat të njihen në ato vlera të cilat reflektojnë pretendimin që një shoqëri ka në këmbim të transferimit të mallrave ose shërbimeve.

SNRF 15 kërkon që shoqëritë të përdorin gjykime, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat domethënëse gjatë aplikimit të secilit prej hapave të modelit. Shoqëria ka bërë gjykimet e nevojshme në raport me zbatimin e SNRF 15.

Standardet e reja të pa-adoptuara dhe amendimet

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të cilat janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit që janë efektive në periudhat e ardhshme të kontabilitetit që shoqëria ka vendosur të mos i aplikojë më herët.

Sipas SNRF 16, kontrata është ose përban një qira, nëse kontrata jep të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e një aktivi të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume. Për kontrata të tillë, modeli i ri kërkon që qiramarrësi të njohë një aktiv për të cilin ka të drejtën e përdorimit si dhe një detyrim. Aktivi zhvlerësohet dhe detyrimi akumulon interes. Kjo do të rezultojë në një model ku shpenzimet janë më të larta në periudhën fillore dhe më pas vijnë duke u ulur për shumicën e qirave, edhe nëse qiramarrësi paguan këste fikse vjetore.

Një qiramarrës mund të zgjedhë të mos zbatojë kërkeshat e standardit për:

- Qiratë afatshkurtra dhe;
- Qiratë për të cilin aktivitë bazë është me vlerë të ulët.

6. Menaxhimi i riskut financiar

Aktivitetet e shoqërisë janë të ekspozuara ndaj një shumëlojshmërie risqesh financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizat, vlerësimin, pranimin dhe manaxhimin e disa shkallëve të riskut ose kombinime të risqeve. Marrja përsipër e riskut është thelbësore për bizneset financiare, dhe risqet operacionale janë pasoja të paevitueshme e të qenurit biznes. Prandaj, qëllimi i shoqërisë është të arrijë një balancë të përshtatshme midis riskut dhe kthimit dhe të minimizojë efektet potenciale të kundërtta në performancën financiare të shoqërisë.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme:

- Risku i kreditimit

- Risku i likuiditetit
- Risku i tregut

Risku i kreditimit

Shoqëria ekspozohet ndaj riskut të kreditimit, i cili është risku që një palë e tretë do të shkaktojë një humbje financiare për shoqërinë duke mos paguar detyrimin. Risku i kreditimit lind parimisht në aktivitetet e shitjes që sjellin si rezultat të drejta për tu arkëtuar dhe aktivitetet e investimit që sjellin tituj të tjera në portofolin e aktiveve të shoqërisë. Risku i kreditimit lind nga paratë dhe ekuivalentët e tyre, depozitat në bankë dhe institucionet financiare, si dhe ekspozimi i kreditimit ndaj klientëve, duke përfshirë kërkesat për tu arkëtuar dhe angazhimet në transaksione. Për bankat dhe institucionet financiare merret në konsideratë vlerësimi i pavarur.

Nëse klientët janë të vlerësuar në mënyrë të pavarur përdoret ky tregues. Në të kundërt nëse nuk ka ndonjë tregues të vlerësimit të pavarur, kontrolli i riskut vlerëson cilësin e kreditimit ndaj klientëve duke marrë në konsideratë pozicionin e tij financiar, eksperiencën e kaluar dhe faktorë të tjera. Kufizimet e riskut individual vendosen bazuar në treguesit e brendshëm ose të jashtëm në përputhje me limitet e vendosura nga shoqëria. Përdorimi i limitit të kredisë monitorohet në vazhdimësi.

Zhvlerësimi për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta matet në shumën që konsiderohet e nevojshme për të mbuluar rreziqet e mundshme në arkëtimin e balanceve të llogarive të arkëtueshme. Mosarkëtimi nuk është gjykuar si i pamundur ndaj dhe shoqëria nuk llogarit zhvlerësim.

Ekspozimi ndaj rsikut të kreditimit

Vlera e mbartur e aktiveve financiare paraqet maksimumin e ekspozimit ndaj riskut të kreditimit.

Maksimumi i ekspozimit ndaj riskut të kreditimit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Llogari të arkëtueshme	18'164'996	24'029'878
Mjete monetare dhe ekuivalentë	143'002'409	125'456'470
Totali	161'167'405	149'486'348

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është rreziku që shoqëria të mos jetë në gjendje të përbushë detyrimet e saj në kohën e maturimit të tyre. Mënyra që ndjek shoqëria në drejtimin e rrezikut të likuiditetit është të sigurojë se do të ketë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet e saj në kohë, në kushte normale dhe të vështira, pa shkaktuar humbje të papranueshme dhe pa rrezikuar reputacionin e shoqërisë.

Shoqëria gjeneron rrjedhje parash të konsiderueshme nga aktivitetet e saj operative në masën që ajo

beson që rreziku i saj i likuiditetit është i pakonsiderueshëm. Gjithashtu, ajo nuk ka detyrime të rëndësishme të rëndësishme ndaj palëve të treta.

Eksposimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Aktivet dhe detyrimet financiare janë detajuar më poshtë:

31 Dhjetor 2019	Totali
Aktivet financiare	
Mjete monetare	143'002'409
Llogari të arkëtueshme	18'164'996
Të tjera të arkëtueshme	54'526'579
Total	215'693'984
Detyrimet financiare	
Llogari të pagueshme furnitorëve	42'552'394
Detyrime të tjera	4'453'362
Titujt e huamarrjes	12'330'348
Total	59'336'104
Rreziku i likuiditetit më 31 dhjetor 2019	156'190'475

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, si kurset e këmbimit dhe normat e interesit do të ndikojnë në të ardhurat e shoqërisë. Objektivi i drejtimit të rrezikut të tregut është të kontrollojë se ekspozimet e tregut janë brenda parametrave të pranueshëm duke optimizuar kthimin.

Rreziku i normave të interesit

Shoqëria mund të përballet me rrezikun e normës së interesit pasi huamarrjet dhe depozitat në datën e pasqyrës së pozicionit finansiar janë me interes të ndryshueshëm në varësi të ndryshimeve të EURIBOR. Ndryshimet e EURIBOR janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
EURIBOR 3m	- 0.379%	-0.310%
EURIBOR 6m	-0.323%	-0.238%
EURIBOR 12m	-0.248%	-0.121%

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria mund të përballet me rrezikun e kursit të këmbimit. Ndryshimet e kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
EURO (EUR)	121.77	123.42
USD (USD)	108.64	107.82

7. Aktive afatgjata materiale

Kosto	Ndërtesa	Impante dhe makineri	Instalime dhe pajisje	Mjete transporti	Patenta	Totali
Më 1 janar 2018	-	122'032'574	-	22'341'796	1'435'900	145'810'270
Shtesa	36'957'000	18'423'897	136'650	13'026'000	-	68'543'547
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	36'957'000	140'456'471	136'650	35'367'796	1'435'900	214'353'817
Shtesa	-	4'332'232	24'993	-	-	4'357'225
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	36'957'000	144'788'600	161'643	35'367'796	1'435'900	218'710'939

Zhvlerësim i Akumuluar	Ndërtesa	Impiante dhe makineri	Instalime dhe pajisje	Mjete transporti	Patenta	Totali
Më 1 janar 2018	-	48'308'463	-	4'545'774	975'583	53'829'821
Shpenzimi i vitit	-	14'386'423	8'175	5'057'503	69'047	19'521'148
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2018	-	62'694'886	8'175	9'603'277	1'044'631	73'350'969
Shpenzimi i vitit	1'847'850	15'797'267	32'119	5'152'904	58'690	22'888'830
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	1'847'850	78'492'153	40'294	14'756'181	1'103'321	96'239'800

Vlera kontabël neto	Ndërtesa	Impiante dhe makineri	Instalime dhe pajisje	Mjete transporti	Patenta	Totali
Më 1 janar 2018	-	73'724'111	-	17'796'022	460'317	91'980'449
Më 31 dhjetor 2018	36'957'000	77'761'482	128'475	25'764'519	391'269	141'002'745
Më 31 dhjetor 2019	35'109'150	66'296'447	121'349	20'611'615	332'579	122'471'139

8.Inventari

Shoqëria nuk ka inventar.

9.Llogari të arkëtueshme

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Llogari të arkëtueshme-klientët	18'164'996	24'029'878
Debitorë dhe kreditorë të tjerë	51'545'080	-
Dogana	35'173	24'640
Tatim fitimi	2'087'308	270'632
Parapagime	859'018	-
Totali	72'691'575	24'325'150

10.Mjete monetare dhe ekuivalentët e tjerë

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Vlera në arkë		
Në Lek	1'330'151	46'217
Në Euro	4'440'075	6'232'733
Në Dollar	706'160	-
Vlera në bankë		
Në Lek	6'249'248	1'415'227
Në Euro	97'680'365	85'412'235
Në Dollar	32'596'410	32'350'058
Totali	143'002'409	125'456'470

11. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra janë të detajuara si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Shpenzime të periudhave të ardhshme		783'333
Totali		783'333

12. Huamarrje afatgjatë

Detyrimet afatgjata në formën e huamarrjes janë të listuara më poshtë sipas vlerës dhe monedhës:

	Monedha	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Credins Bank	EUR	12'330'348	20'741'789
Totali		12'330'348	20'741'789

13. Detyrime të pagueshme ndaj furnitorëve.

		31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Detyrime ndaj furnitorëve		42'552'394	36'490'477
Totali		42'552'394	36'490'477

14. Detyrime të tjera

		31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Paga dhe shpërblime		269'304	84'772
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore		917'162	871'471
Tatimi mbi të ardhurat personale		220'289	139'607

Tatimi ne burim	176'465	176'319
TVSH	2'868'642	3'807'671
Kreditorë të tjera	1'500	1'500
Totali	4'453'362	5'081'340

15. Të ardhurat nga shitja dhe të tjera

Të ardhurat nga shitja dhe të ardhurat e tjera të shfrytëzimit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	297'426'324	296'644'767
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	2'140'023	661'382
Totali	299'566'347	297'306'149

16. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Paga dhe shpërblime	39'419'900	36'342'293
Shpenzime për sigurime	6'317'877	5'953'312
Totali	45'737'777	42'295'605

17. Shpenzime amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Shpenzime amortizimi	22'888'830	19'521'148
Totali	22'888'830	19'521'148

18. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, përbëhet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Shpenzime per blerje materialesh	2'015'023	661'382
Mirëmbajtje dhe riparime	1'964'039	2'543'886
Shpenzime ambalazhi	164'067	-
Shpenzime tekstile	32'095'817	29'684'464
Shpenzime detergjentësh	65'412'345	56'189'098
Shpenzime kripe	252'708	640'927
Shpenzime larje	9'699'550	9'388'350
Shpenzime gaz i lengshem	9'155'471	10'266'998
Siguracione	321'983	290'241
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	139'303	135'694
Shpenzime për pritje përcjellje	348'221	-
Shpenzime udhetimi, dieta	-	26'817
Shpenzime karburant	11'623'335	7'389'443
Shpenzime energji, avull, uje	4'600'457	5'081'344
Qira	14'117'640	14'117'640
Shpenzime tatimore dhe doganore	113'614	918'768
Shpenzime penalitete dhe gjoba	32'658	73'545
Transporti	-	233'650
Të ndryshme	992'777	248'291
Të tjera	3'655'450	5'093'180
Totali	156'704'458	142'983'718

19. Shpenzimet financiare neto

Shpenzimet financiare neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 përbëhet si më poshtë:

Të ardhurat financiare	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të ardhura nga interesi	2'097'869	31'692
Fitim nga kursi i kembimit	11'000	-
Totali i të ardhurave financiare	2'108'869	31'692

Shpenzimet financiare	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Shpenzime interesi	1'187'722	2'200'491
Shpenzime komisione	244'780	192'653
Humbje nga kursi i këmbimit	623'318	5'058'281
Totali i shpenzimeve financiare	2'055'820	7'451'425
Të ardhura/(shpenzime)financiare neto	53'049	7'419'733

20.Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin i llogaritur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 bazohet në detyrimin për tatim fitimin sipas legjislacionit fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (Në vitin 2018 15%)

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Fitim/Humbje para fitimit	74'288'331	85'085'945
Shpenzime të pazbritshme	105'346	321'836
Fitim/Humbje ushtrimore(e tatushme)	74'393'677	85'407'781

Humbje të mbartura

Fitim/Humbje e tatueshme	74'393'677	85'407'781
Norma e tatimit	15%	15%
Tatimi i fitimit	11'159'051	12'811'168
Fitim/Humbje neto	63'129'279	72'274'778

21.Ngjarje pas datës së bilancit

Pas datës së bilancit kontabël nuk kanë ndodhur ngjarje që mund të kërkojnë ndonjë rregullim ose prezantim në pasqyrat financiare.

HARTUESI I PASQYRAVE FINANCIARE

BUKURIJE MARKO

Bukuri Marko
Z

ADMINISTRATOR I SHOQERISE

KRISTINKA LEKA

